



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 93 .Prot.

Rrogozhinë, më 27.12.2024

VENDIM

Nr. 70 , datë 27.12.2024

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN
PARASHKOLLOR**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.12.2024, diskutoi dhe mori në shqyrtim projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë me shkresën Nr.5268. Prot, datë 24.12.2024 "Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor Bashkia Rrogozhinë ", si dhe Relacionin e këtij projektvendimi me Nr.5268.Prot datë 19.12.2024.

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar Urdhërit nr.239, datë 15.05.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të përmirësimit të shërbimit për Arsimin Parashkollor, në kuadër të marrëveshjes dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkisë Rrogozhinë dhe Projektit "Bashki të Forta" BtF. me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

1. Miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor Bashkia Rrogozhinë sipas materialit bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektë financiar për Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor është parashikuar në projektbuxhetin afatmesëm (PBA) 2025-2027 në kodet 6020300 për mjetet didaktike dhe 6025300 për përmirësim infrastrukture në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë për secilin vit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë Sporteve, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë Rrogozhinë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

ZËVENDËSKRYETAR I KESHILLIT

ERIND TOSKU



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shkurtori" Email:brrogozhine@gmail.com